

VENDIM
Nr. 656, datë 27.8.2020

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 513, DATË 13.6.2013, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË PROCEDURAVE E
TË DOKUMENTACIONIT PËR HYRJEN, QËNDRIMIN DHE TRAJTIMIN E TË
HUAJVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 108/2013, “Për të huajt”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit dhe ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe të ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 3, të indeksit A, në kreun II, të vendimit nr. 513, datë 13.6.2013, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, hiqet fjalia: “... Për të huajt që aplikojnë për vizë elektronike tipi C apo D, aplikohet një tarifë shtesë (fikse) për shërbimin, prej 20 eurosh, krahas tarifës së vizës së përcaktuar në aneksin nr.4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij ...”.

2. Ngarkohen Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe